



**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës**  
**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**



01. Nr. 013-20

Më 30.09.2020

Mamushë

Në bazë të dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr.03/L-048 neni 20, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale neni 40. al2. pika b), neni 18.4 të Statutit të Komunës së Mamushës, Kuvendi i Komunës së Mamushës bje këtë:

**V E N D I M**

**Miratimi i Planit të Buxhetit për vitet 2021-2023**

**Neni 1**

Në mbledhjen e mbajtur më datë 30.09.2019 Kuvendi i Komunës së Mamushës, ka aprovuar **Planin e Buxhetit për vitin 2021** dhe vlerësimet në strukturën buxhetore sipas kategorive ekonomike për vitin 2022-2023

**Neni 2**

| Kategorit e shpenzimeve   | Viti 2021    | Viti 2022    | Viti 2023    |
|---------------------------|--------------|--------------|--------------|
| Numri i Stafit            | 156          | 156          | 156          |
| Paga dhe Meditje          | 1,120,022.00 | 1,143,168.46 | 1,148,884.30 |
| Mallra dhe Shërbime       | 324,960.00   | 339,258.10   | 332,993.18   |
| Shpenzime Komunale        | 31,000.00    | 31,487.40    | 32,799.38    |
| Subvencione dhe Transfere | 40,000.00    | 42,626.32    | 45,133.75    |
| Shpenzime Kapitale        | 190,421.00   | 458,590.25   | 507,588.79   |
| Total:                    | 1,706,403.00 | 2,015,130.53 | 2,067,399.40 |

Pjesë e këtij vendimi janë Tabelat 4.1 dhe 4.3 të sistemit BDMS dhe Tabela 4.2 sipas sistemit PIP për vitet 2021-2023 dhe Plani i Buxhetit për vitet 2023 -2023 sipas programeve dhe nën-programeve, buxheti gjinor dhe indikatorët e performancës sipas programit buxhetor.

| Burimet e Financimit  | Viti 2021    | Viti 2022    | Viti 2023    |
|-----------------------|--------------|--------------|--------------|
| Granti I Përgjithshëm | 995,431.00   | 1,039,406.00 | 1,082,514.66 |
| Granti për Arsim      | 455,887.00   | 525,634.75   | 528,191.05   |
| Granti për Shëndetesi | 198,151.00   | 378,544.28   | 380,437.00   |
| Të Hyrat Vetanake     | 56,934.00    | 71,545.51    | 76,256.69    |
| Total:                | 1,706,403.00 | 2,015,130.54 | 2,067,399.40 |

### Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi në ditën e miratimit të tij në Asamble.

Me këtë vendim njoftohet :

- Zyra e Kryetarit të Komunës
- Të gjitha drejtorit
- Arkivi
- Departamenti i Buxhetit Komunal – MF

Kryesuesi i Kuvendit





**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**

**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës**

**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**



Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit, Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nenit 9, bazuar sipas nenit 18 të Statutit të Komunës së Mamushës, Kuvendi I Komunës së Mamushës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2020, nxjerr këtë:

## **VENDIM**

**Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021**

### **Neni 1**

#### **Normat Tatimore**

Në zbatim të Ligjit Nr.06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Mamushës cakton normat tatimore për vitin 2021 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

- Për njësité bujqësore të parcelave----- 0.15
- Për njësité bujqësore të objekteve----- 0.15
- Për njësité pyjore të parcelave----- 0.15
- Për njësité rezidenciale të parcelave----- 0.15
- Për njësité rezidenciale të objekteve----- 0.16
- Për njësité komerciale të parcelave----- 0.15
- Për njësité komerciale të objekteve----- 0.18
- Për njësité industrial të parcelave----- 0.15
- Për njësité industriale të objekteve-----0.17

## **Neni 2**

### **Zbatimi**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Tatimit në Pronë.

## **Neni 3**

### **Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal dhe do të filloj së zbatuari nga 1 Janari 2021.

*Iu dergohet:*

- *Komitetit për politikë dhe Financa*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa*
- *Ministrisë për Financa*
- *Zyrës të Tatimit në Pronë*
- *Arkivit komunal*

*Vendimi Nr. 014-20*

*Datë 30.09.2020*

*Kryesuesi I KK*

*Buyar Mazrek*





**Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti**

**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës**

**Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa**



Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (2), nenit 17 paragrafi 1 pika (f) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 34 të Ligjit për Mbeturina, Nr. 04/L-060, si dhe sipas Statutit të Komunës së Mamushës, Kuvendi I Komunës së Mamushës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2020, nxjerr këtë:

## **VENDIM**

**Për miratimin e Rregullorës për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Mamushës**

### **Neni 1**

1.1 Në mbledhjen e mbajtur më datën 30.09.2020 Kuvendi I Komunës së Mamushës, ka votuar me vota unanime për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Mamushës.

### **Neni 2**

#### **Zbatimi**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Planifikimit Urban dhe mjedisit, Gjeodezi dhe Kadastër.

### **Neni 3**

#### **Hyrja në fuqi**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Mamushës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës MAPL-së, conform nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, dhe Rregullorës së MAPL-së Nr.01/2017, për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në web-faqen zyrtare të Komunës.

*Iu dergohet:*

- *Zyra e Kryetarit të Komunës*
- *Drejtoria për Planifikimit urban dhe mjedisit, Gjeodezi dhe Kadastër*
- *Ministria e Pushtetit Lokal si dhe*
- *Arkivit komunal*

*Vendimi Nr. 015-20*

*Datë 30.09.2020*

*Kryesuesi I KK*

*Buyar Mazrek*

